

SUN PALASË

MARKA DHE TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE

Politika e përdorimit, autorizimit dhe mbrojtjes së markës dhe materialeve zyrtare

Publikuar nga Golden Key sh.p.k.

Projekti rezidencial Sun Palasë - Palasë, Himarë, Vlorë

1. Qëllimi dhe fusha e zbatimit

Ky dokument përcakton rregullat për përdorimin e markës “Sun Palasë”, identitetit të saj vizual, materialeve informative, promociionale, arkitekture dhe mediatike, si dhe mënyrën e reagimit ndaj përdorimeve të paautorizuara.

Politika zbatohet për çdo person fizik ose juridik, agjenci imobiliare, ndërmjetës, portal, media, bashkëpunëtor, nënkontraktor, krijues përmbajtjeje, operator reklamimi ose subjekt tjetër që përdor, publikon, ripublikon, shpërndan ose përpunon materiale që lidhen me projektin Sun Palasë.

Aksesueshmëria publike e një materiali në website, rrjete sociale ose kanale të tjera zyrtare nuk përbën në vetvete autorizim apo licencë për kopjim, modifikim, ripublikim, reklamim ose përdorim komercial.

2. Subjekti përgjegjës dhe marka Sun Palasë

Golden Key sh.p.k., NIPT M11926008G, me adresë Rruga “Faik Konica”, Rezidenca Lion, Tiranë, është investitori i projektit rezidencial Sun Palasë dhe administron përdorimin zyrtar të emrit, identitetit të markës dhe kanaleve zyrtare të projektit, në përputhje me të drejtat që i takojnë sipas ligjit dhe marrëveshjeve përkatëse.

Emri “Sun Palasë”, logoja, elementet dalluese të identitetit vizual dhe mënyra e paraqitjes së markës përdoren vetëm sipas standardeve të përcaktuara në Brand Book / Manualin e Përdorimit Vizual të Markës.

Golden Key sh.p.k. ka autorizuar VIB - Growth Platform për menaxhimin e strategjisë së marketingut “Sun Palasë - 360/365”, komunikimin e markës dhe mbikëqyrjen e përdorimit të saj, brenda kompetencave të përcaktuara nga investitori.

3. Baza ligjore

Kjo politikë mbështetet në legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë për markat tregtare, të drejtën e autorit, pronësinë industriale, konkurrencën e pandershme dhe përgjegjësinë civile, për aq sa secila dispozitë është e zbatueshme për rastin konkret.

- Ligji nr. 52/2025, datë 03.07.2025, “Për markat tregtare”, përfshirë të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi dhe mbrojtjen ndaj shkeljeve.
- Ligji nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, për materialet që përbëjnë vepra të mbrojtura.
- Ligji nr. 9947, datë 07.07.2008, “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar, për fushat e pronësisë industriale që vijojnë të rregullohen prej tij.
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë dhe dispozitat e tjera të zbatueshme për mbrojtjen nga dëmi, publikimi mashtrues dhe konkurrenca e pandershme.

Mbrojtja konkrete e çdo materiali varet nga natyra e tij, autorësia, regjistrimi kur kërkohet, si dhe të drejtat e fituara ose të licencuara me kontratë.

4. Asetet dhe materialet e mbrojtura

Në varësi të natyrës së tyre dhe të të drejtave përkatëse, mbrojtja dhe rregullat e kësaj politike përfshijnë:

- emrin “Sun Palasë”, logon dhe elementet dalluese të identitetit të markës;
- Brand Book-un, tipografinë, sistemin grafik, kompozimet dhe format e miratuara të komunikimit;
- fotografitë, renderat, videot, animacionet, grafikët, ilustrimet dhe materialet promociionale;

- planet, skicat, vizualizimet dhe materialet arkitekturore, në masën që Golden Key sh.p.k. ka të drejtën e përdorimit, licencimit ose kontrollit të tyre;
- tekstet e website-it, broshurat, prezantimet, përshkrimet e pronave, sloganet dhe mesazhet zyrtare;
- materialet audio, voice-over, kolonat zanore dhe elementet audiovizuale, sipas të drejtave përkatëse;
- bazat e të dhënave, katalogët, strukturat informative dhe materialet e rezervuara për bashkëpunëtorët;
- domain-et, profilet zyrtare sociale dhe identitetet digjitale të projektit.

5. Burimet dhe kanalet zyrtare

Informacioni i konsideruar zyrtar është ai i publikuar ose i konfirmuar nga Golden Key sh.p.k. dhe kanalet e autorizuar të projektit. Sipas dokumentacionit aktual të projektit, kanalet përfshijnë website-in www.sunpalse.al dhe profilet zyrtare Sun Palasë në Facebook, Instagram, LinkedIn, YouTube, X, TikTok dhe Google Maps.

Kontakti zyrtar i deklaruar për projektin është info@sunpalase.al. Përpara përdorimit të materialeve për qëllime tregtare, reklamimi ose ndërmjetësimi, përdoruesi duhet të verifikojë autorizimin dhe versionin më të fundit të materialit.

6. Parimi i autorizimit

Asnjë palë e tretë nuk fiton të drejtë mbi markën ose materialet Sun Palasë vetëm sepse ka akses në to, i ka marrë nga një klient, bashkëpunëtor, rrjet social, motor kërkimi, portal, mesazh elektronik ose burim tjetër.

Përdorimi tregtar, reklamues, promocional ose ndërmjetësues kërkon autorizim paraprak kur nuk mbulohet shprehimisht nga një marrëveshje e vlefshme me Golden Key sh.p.k. ose nga një e drejtë tjetër ligjore.

Autorizimi për një pronë, material, kanal, periudhë ose fushatë të caktuar nuk duhet të interpretohet si autorizim i përgjithshëm për materiale, prona ose përdorime të tjera.

7. Përdorime të paautorizuara dhe shkelje të markës

Pa cenuar kufizimet dhe përjashtimet që mund të parashikojë ligji, konsiderohen përdorime të paautorizuara ose potencialisht cenuese, sipas rastit:

- përdorimi i emrit ose logos Sun Palasë në reklamë, ofertë, broshurë, website, portal ose rrjet social pa autorizimin e kërkuar;
- ndryshimi, deformimi, rrotullimi, recolorimi, rindërtimi ose përdorimi i një versioni jozyrtar të logos;
- mbivendosja e një logoje, watermark-u, kontakti, emri agjencie ose shenje tjetër mbi logon apo materialet zyrtare, kur kjo nuk është miratuar;
- heqja, fshehja ose ndryshimi i logos, njoftimit të autorësisë, watermark-ut ose elementeve identifikuese nga materiali zyrtar;
- përdorimi i markës në mënyrë që krijon përshtypjen e rreme se një subjekt është degë, partner zyrtar, përfaqësues, agent ekskluziv ose shitës i autorizuar;
- përdorimi i emrit Sun Palasë si emër biznesi, emër faqeje, profil social, grup, kanal, domain ose subdomain që mund të krijojë konfuzion për burimin zyrtar;
- regjistrimi ose përdorimi i domain-eve, username-ve ose profileve që imitojnë, kopjojnë ose janë në mënyrë konfuze të ngjashme me identitetin zyrtar;
- përdorimi i markës në reklama të sponsorizuara, fjalë kyçe, tituj reklamash, metadata ose forma të tjera të marketingut digjital në mënyrë që krijon konfuzion mbi lidhjen me projektin;
- përdorimi i markës ose materialeve Sun Palasë për promovimin e një projekti, prone ose shërbimi tjetër;

- përdorimi i materialeve në kontekst mashtrues, denigrues, të pasaktë ose që mund të dëmtojë reputacionin dhe identitetin e projektit.

8. Fotografitë, renderat, videot dhe materialet vizuale

- Ndalohet kopjimi, shkarkimi dhe ripublikimi për qëllime tregtare pa autorizimin e kërkuar.
- Ndalohet prerja, retushimi, ndryshimi i ngjyrave, kompozimit, sfondit, tekstit ose elementeve të një renderi apo fotografie kur ndryshimi nuk është miratuar.
- Ndalohet vendosja e kontakteve, çmimeve, logove, watermark-eve ose elementeve grafike të palëve të treta mbi materialet zyrtare pa miratim.
- Nuk lejohen publikime me pamje nga kantieri gjatë fazës së punimeve, përveç materialeve zyrtare ose rasteve të autorizuara posaçërisht.
- Ndalohet paraqitja e një vizualizimi të modifikuar si pamje zyrtare ose si përfaqësim i garantuar i produktit përfundimtar.
- Ripostimi i lejuar duhet të ruajë materialin, burimin dhe kuptimin e tij, sipas kushteve të autorizimit dhe rregullave të kanalit përkatës.

9. Planet, arkitektura dhe vizualizimet teknike

Planet, skicat, renderat arkitekturore, vizualizimet e fasadave, ambienteve dhe peizazhit mund të përmbajnë të drejta të autorëve, studiove projektuese ose palëve të tjera. Përdorimi i tyre lejohet vetëm në masën e autorizuar nga mbajtësit përkatës të të drejtave dhe nga Golden Key sh.p.k., kur kërkohet.

- Ndalohet ndryshimi i planimetrive, sipërfaqeve, emërtimeve, dimensioneve ose elementeve teknike dhe publikimi i versionit të ndryshuar si material zyrtar.
- Ndalohet përdorimi i materialeve arkitekturore për të krijuar produkte promociionale, modele 3D ose variante alternative pa miratimin e nevojshëm.
- Çdo material që mund të krijojë pritshmëri mbi konfigurimin, pamjen ose standardin përfundimtar duhet të jetë në përputhje me informacionin zyrtar të projektit.

10. Tekstet dhe informacioni tregtar

- Tekstet dhe mesazhet zyrtare nuk duhet të ndryshohen në mënyrë që të tjetërsohet kuptimi, pozicionimi ose informacioni i projektit.
- Nuk lejohet publikimi i informacioneve të pakonfirmuara mbi çmimet, disponibilitetin, afatet, sipërfaqet, shërbimet, standardet ose kushtet tregtare.
- Sipas rregullave aktuale të projektit, nuk lejohet publikimi i çmimeve të shitjes me njësinë €/m² ose lek/m².
- Në komunikimet vizuale nuk lejohen termat “shkëmbim”, “klering”, “ndërrim” ose formulime të ngjashme që sugjerojnë një marrëdhënie të paautorizuar ndryshe nga kushtet zyrtare tregtare.
- Nuk lejohet kopjimi i një materiali zyrtar duke e prerë, shkurtuar ose transformuar në mënyrë që të humbasë konteksti ose të krijohet informacion i pasaktë.

11. Agjencitë imobiliare, ndërmjetësit dhe bashkëpunëtorët

Çdo subjekt që reklamon për shitje një pronë në Sun Palasë duhet të ketë një bazë të ligjshme dhe të dokumentuar për ndërmjetësimin e asaj prone dhe, kur kërkohet nga marrëveshjet e projektit, autorizimin për përdorimin e materialeve të markës.

- Publikimi ose reklamimi duhet të kufizohet te prona ose pronat për të cilat subjekti ka marrëveshje të vlefshme.
- Marrëveshja ose autorizimi duhet t'i bëhet i ditur departamentit përkatës të projektit kur kërkohet.
- Materialet duhet të merren nga burimet e miratuara dhe të përdoren në versionin e autorizuar.
- Statusi i bashkëpunëtorit nuk lejon deklarime si “ekskluziv”, “zyrtar” ose të ngjashme, përveçse kur ky status është dhënë shprehimisht.
- Ndalohet përdorimi i materialeve të projektit si mjet për të gjeneruar kontakte për prona të tjera ose për të ridrejtuar interesin drejt projekteve konkurrencte.

12. Rrjetet sociale, portalet dhe marketingu digjital

- Krijimi i faqeve ose profileve që mund të perceptohen si kanale zyrtare të Sun Palasë kërkon autorizim.
- Titulli, fotografia e profilit, bio, përshkrimi, hashtag-et dhe materialet promocionale nuk duhet të krijojnë përshtypje të rreme për një lidhje zyrtare.
- Reklammat me pagesë që përdorin markën ose materialet zyrtare duhet të jenë të autorizuar kur ligji ose marrëdhënia kontraktuale e kërkon.
- Nuk lejohet imitimi i website-it, landing pages, formularëve të kontaktit ose komunikimeve zyrtare për mbledhjen e kërkesave të klientëve në mënyrë mashtruese.
- Nuk lejohet publikimi i numrave të telefonit, email-eve ose kontakteve të palëve të treta brenda materialit zyrtar në një mënyrë që krijon përshtypjen se janë kontakte të Sun Palasë.

13. Inteligjenca Artificiale dhe përmbajtjet sintetike

- Nuk lejohen vizualizime të objekteve, ambienteve, fasadave ose peizazhit të Sun Palasë të krijuara ose të modifikuara me Inteligjencë Artificiale dhe të paraqitura si materiale zyrtare pa miratimin përkatës.
- Çdo vizualizim i tillë që synohet të përdoret zyrtarisht duhet të verifikohet nga funksioni përgjegjës për arkitekturën dhe më pas nga marketingu.
- Nuk lejohet përdorimi i AI për të hequr logo, watermark, elemente identifikuese ose për të rikrijuar materiale zyrtare me qëllim shmangien e kufizimeve të përdorimit.
- Nuk lejohet krijimi i videove, zërave, avatarëve ose deklaratave sintetike që krijojnë përshtypjen se janë prodhuar, miratuar ose komunikuar nga Sun Palasë pa autorizim.

14. Audio, muzikë dhe materiale audiovizuale

- Nuk lejohet zëvendësimi ose përdorimi i paautorizuar i voice-over, muzikës, kolonave zanore ose elementeve të tjera të një materiali zyrtar.
- Një ripublikim nuk transferon te përdoruesi të drejtat mbi muzikën, zërin, fotografinë, videon ose elemente të tjera të licencuara nga palë të treta.
- Përdoruesi mban përgjegjësi për licencat që kërkohen nga platforma ose nga mbajtësit e të drejtave për çdo element që ai shton vetë.

15. Përmbajtja për stilin e jetesës dhe identitetin e rezidencës

Komunikimi institucional mbi stilin e jetesës, komunitetin, eksperiencën e rezidencës dhe pozicionimin e përgjithshëm të Sun Palasë administrohet nga projekti dhe bashkëpunëtorët e autorizuar. Palët e treta nuk duhet të krijojnë pretendime, premtime ose narrativa që paraqiten si komunikim zyrtar pa miratim.

16. Raste të tjera të shkeljes ose keqpërdorimit

- shitja, licencimi, transferimi ose shpërndarja te persona të tjerë e materialeve të marra në mënyrë të kufizuar ose konfidenciale;
- përdorimi i materialeve pas përfundimit, pezullimit ose revokimit të autorizimit, kur nuk ekziston një bazë tjetër ligjore për përdorimin;
- paraqitja e dokumenteve, ofertave ose komunikimeve të modifikuara si dokumente të lëshuara nga Golden Key sh.p.k. ose Sun Palasë;
- përdorimi i markës në materiale që cenojnë reputacionin, krijojnë konfuzion ose mashtrojnë publikun mbi origjinën, cilësinë, autorizimin ose marrëdhënien tregtare;
- shpërndarja e materialeve të rezervuara për bashkëpunëtorë, klientë ose përdorues të identifikuar, jashtë qëllimit për të cilin janë dhënë.

17. Përdorime që mund të lejohen

Kjo politikë nuk synon të kufizojë përdorimet që lejohen shprehimisht nga ligji. Në varësi të rastit, referimi faktik ndaj emrit Sun Palasë për qëllime informative, gazetareske, akademike ose të tjera të ligjshme mund të jetë i lejueshëm, me kusht që të mos krijojë përshtypje të rreme autorizimi, të mos cenojë të drejtat e autorit ose të markës dhe të respektojë burimin e materialit.

Për përdorime tregtare ose raste të paqarta rekomandohet marrja e autorizimit paraprak me shkrim.

18. Procedura e autorizimit

- Kërkesa duhet të identifikojë subjektin kërkues, pronën ose qëllimin e bashkëpunimit dhe materialet që kërkohen.
- Golden Key sh.p.k. ose struktura e autorizuar prej saj mund të kërkojë dokumentacion që provon marrëdhënien e subjektit me pronën ose projektin.
- Autorizimi mund të përcaktojë materialet, kanalet, afatin, territorin, formatin dhe kushtet e përdorimit.
- Materialet e publikuara duhet të respektojnë Brand Book-un dhe versionet më të fundit të miratuara.
- Golden Key sh.p.k. mund të kërkojë korrigjimin ose ndërprerjen e një përdorimi që tejkalon autorizimin e dhënë.

19. Konstatimi dhe dokumentimi i shkeljeve

Kur konstatohet një përdorim potencialisht i paautorizuar, Golden Key sh.p.k. ose përfaqësuesit e autorizuar mund të dokumentojnë publikimin, burimin, datën, llogarinë, domain-in, reklamën, materialin dhe çdo të dhënë tjetër të nevojshme për verifikimin e rastit.

Dokumentimi i një rasti nuk nënkupton automatikisht se është konstatuar përfundimisht një shkelje ligjore; vlerësimi bëhet sipas rrethanave, të drejtave përkatëse dhe legjislacionit të zbatueshëm.

20. Masat ndaj përdorimit të paautorizuar

Në varësi të natyrës dhe rëndësisë së rastit, Golden Key sh.p.k. rezervon të drejtën të përdorë mjetet kontraktuale dhe ligjore të zbatueshme, përfshirë:

- kërkesën për korrigjim, ndërprerje, heqje ose çaktivizim të materialit;
- kërkesën për heqjen e logos, markës, materialeve ose pretendimeve të paautorizuara;

- raportimin e përmbajtjes të rrjetet sociale, platformat e reklamimit, motorët e kërkimit, hosting providers ose operatorët përkatës, sipas procedurave të tyre;
- revokimin ose kufizimin e autorizimit kontraktual, kur kjo parashikohet nga marrëveshja;
- kërkimin e masave të përkohshme ose përfundimtare pranë autoriteteve apo gjykatave kompetente, kur plotësohen kushtet ligjore;
- kërkimin e kompensimit të dëmit dhe mjeteve të tjera juridike të parashikuara nga ligji, kur janë të zbatueshme.

21. Njoftimi për ndërprerjen e përdorimit

Kur një palë njoftohet se përdorimi i saj nuk është i autorizuar, ajo duhet të verifikojë menjëherë bazën e përdorimit dhe, kur kërkesa është e justifikuar, të ndërpresë ose korrigjojë përdorimin brenda afatit të komunikuar.

Dërgimi i linkut të kësaj politike mund të shërbejë si referencë për rregullat publike të përdorimit të markës, por çdo kërkesë konkrete për heqje ose ndërprerje duhet të identifikojë materialin ose përdorimin përkatës.

22. Raportimi i një përdorimi të dyshuar

Përdorimet e dyshuara si të paautorizuara mund të raportohen në kontaktet zyrtare të projektit. Raportimi duhet, kur është e mundur, të përmbajë linkun e publikimit, emrin e subjektit, screenshot ose kopje të materialit dhe datën e konstatimit.

Email zyrtar: info@sunpalase.al

23. Përditësimi i politikës

Golden Key sh.p.k. mund ta përditësojë këtë politikë për të reflektuar ndryshime në markë, kanalet zyrtare, mënyrën e bashkëpunimit ose legjislacionin e zbatueshëm. Versioni i publikuar në website-in zyrtar konsiderohet versioni aktual për qëllime informimi.

Ndryshimet e kësaj politike nuk zëvendësojnë ose ndryshojnë automatikisht kushtet e kontratave ekzistuese, përveç rasteve kur kjo parashikohet në marrëveshjen përkatëse ose lejohet nga ligji.

24. Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni

Kjo politikë interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Çdo mosmarrëveshje trajtohet sipas procedurave dhe kompetencave të përcaktuara nga ligji dhe, kur ekziston, nga marrëveshja përkatëse ndërmjet palëve.

25. Të dhënat zyrtare të projektit

Investitori	Golden Key sh.p.k.
NIPT	M11926008G
Projekti	Sun Palasë - Rezidencë
Vendndodhja	Palasë, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë
Arkitektura	JA Joubert Architecture, Rotterdam, Holandë
Marketingu	VIB - Growth Platform
Website	www.sunpalse.al

Shënim

Ky dokument është politikë publike e përdorimit të markës dhe materialeve Sun Palasë. Ai nuk zëvendëson kontratat, licencat ose autorizimet individuale dhe nuk përbën opinion juridik për një mosmarrëveshje konkrete. Përpara publikimit përfundimtar rekomandohet verifikimi nga këshilltari ligjor i kompanisë i statusit të regjistrimit të markës dhe i të drejtave kontraktuale mbi materialet e krijuara nga palë të treta.